

**AKT THEMELIMI**  
**"FUTUREPRO" SHPK**

Z. Hamza ABURAYYAN, I angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë 07.09..2022, shpreh vullnetin dhe angazhimin e tij për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

**1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.**

Emri i shoqërisë do të jetë "FUTUREPRO" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

**2. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.**


Z.Hamza ABURAYYAN, i biri i Mohammad-it, i datëlindjes 25.07.1963 lindur në Halhul, Jordani dhe banues në Tiranë, në adresën: "Mine Peza", Nr.102, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr.Q572721 dhe Nr.Personal 9631009234, i cili njuh dhe flet shumë mirë gjuhën shqipe.

**3. Objekti i veprimtarisë.**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

1. Veprimtari në fushën e pasurive të paluajtshme blerjes, shitjes, ndërmjetësimit, investimit dhe zhvillimit të tyre, duke përfshirë këtu ndërtesat komerciale, qendrat tregtare, banesa të përbashketa, ndërtesat me apartamente, zhvillimin e tokave që janë të pa zhvillura ose ska ndërtim në to, etj.
2. Veprimtari në fushën e ndërtimit, duke kryer punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, muratur betoni, beton arme të zakonshme, punime shëmbjesh, blerje dhe shitje materiale ndërtimi, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, punime restaurimi, mirëmbatje e punime shërbimi, të zakonshme të sistemit komunal etj.
3. Tregtim i lëndëve të para ndërtimore, import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve të ndryshme ndërtimore etj,
4. Mbikqyrje të ndërtimit të pasurive të paluajtshme si ato civile, industriale, ushtarake, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukture, etj.
5. Importimin dhe eksportimin e lëndëve të para, gjysëmprodukteve dhe produkteve të gatshme, dhe tregtinë e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
6. Aktivitet i projektimit, instalimit dhe konsulencës në fushën e energjisë dhe telekomunikacionit dhe teknologjisë së informacionit, import-eksport i shërbimeve të mësipërme;
7. Tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport të automjeteve, pjesëve të këmbimit dhe të materialeve ndihmëse.
8. Real Estate, blerjen, shitjen dhe dhënien me qera të pasurive të paluajtshme dhe të luajshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
9. Import -Ekspot;
10. Autotransporte;
11. Sipërmarrje publike dhe private;

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.



4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 4, Tiranë .**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

- Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 Lekë** (njëqind mijë).
- Kapitali përbëhet nga **1 (një) kuotë**.
- Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Hamza Aburayyan, do të zotëroj **100 %** të kuotës në kapitalin themeltar të shoqërisë ose **100 000 Lekë** (njëqind mijë).

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori.

- Administratori emërohet për një mandat **5 (pesë) vjeçar**. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Hamza Aburayyan**.

9. Likuidimi i shoqërisë.

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

Z. Hamza Aburayyan

*Hamza Aburayyan*

Tiranë, më 07/09/2022

---

**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**" FUTUREPRO SHPK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" – i ndryshuar, si dhe të Aktit të themelimit të shoqërisë "FUTUREPRO" SHPK, veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

1.1 Shoqëria do të zhvilloj veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

**Neni 2**  
**Ortakët e shoqërisë**

2.1 Ortaku i Vetëm i shoqërisë është:

**Z.Hamza ABURAYYAN**, i biri i Mohammad-it, i datëlindjes 25.07.1963 lindur në Halhul, Jordani dhe banues në Tiranë, në adresën: "Mine Peza", Nr.102, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr.Q572721 dhe Nr.Personal 9631009234, i cili njihet dhe flet shumë mirë gjuhën shqipe.

**Neni 3**  
**Forma ligjore**

3.1 Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

4.1 Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 5**  
**Selia**

5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 4, A 1, Tiranë .

---

5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

## Neni 6 Dokumentet e shoqërisë

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
- a) *numrin unik të identifikimit;*
  - b) *formën ligjore të shoqërisë;*
  - c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
  - ç) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
  - d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

## Neni 7 Objekti i veprimtarisë

7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Veprimtari në fushën e pasurive të paluajshme blerjes, shitjes, ndërmjetësimit, investimit dhe zhvillimit të tyre, duke përfshirë këtu ndërtesat komerciale, qendrat tregtare, banesa të përbashketa, ndërtesat me apartamente, zhvillimin e tokave që janë të pa zhvillura ose ska ndërtim në to, etj.
- Veprimtari në fushën e ndërtimit, duke kryer punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, muratur betoni, beton arme të zakonshme, punime shëmbjesh, blerje dhe shitje materiale ndërtimi, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, punime restaurimi, mirëmbajtje e punime shërbimi, të zakonshme të sistemit komunal etj.
- Tregtim i lëndëve të para ndërtimore, import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve të ndryshme ndërtimore etj,
- Mbikqyrje të ndërtimit të pasurive të paluajshme si ato civile, industriale, ushtarake, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukture, etj.
- Importimin dhe eksportimin e lëndëve të para, gjysëmprodukteve dhe produkteve të gatshme, dhe tregtinë e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Aktivitet i projektimit, instalimit dhe konsulencës në fushën e energjisë dhe telekomunikacionit dhe teknologjisë së informacionit, import-eksport i shërbimeve të mësipërme;
- Tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport të automjeteve, pjesëve të këmbimit dhe të materialeve ndihmëse.
- Real Estate, blerjen, shitjen dhe dhënien me qera të pasurive të paluajshme dhe të luajshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Import -Ekspot;
- Autotransporte;
- Sipërmarrje publike dhe private;

---

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 8**  
**Kapitali themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 Lekë** (njëqind mijë).
- 8.2 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- Ortaku i Vetëm, Z.Hamza Aburayyan do të zotëroj **100 %** të kuotës në kapitalin themeltar të shoqërisë ose **100 000 Lekë** (njëqind mijë).

**Neni 9**  
**Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

**Neni 10**  
**Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

**Neni 11**  
**Asambleja e Ortakëve**

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
- *ndryshimi i dispozitave të statutit,*
  - *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,*
  - *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
  - *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
  - *miratimi i llogarive vjetore (bilancit),*
  - *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,*

- 
- *mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.*
- 11.3 Asambleja e Ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përmbaj ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

#### **Neni 12** **Vendimmarrja**

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50 % të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

#### **Neni 13** **Administratori**

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë është: **Z. Hamza Aburayyan**
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtoj veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësoj shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e Ortakëve.
- 13.4 Administratori, bazuar në një vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të emëroj drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
- 13.5 Administratori i Shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Ortakëve.

---

**Neni 14**  
**Kontrolli financiar**

14.1 Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

**Neni 15**  
**Viti financiar**

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 16**  
**Bilanci dhe Dividendët**

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e Ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.
- 16.3. Deri në shlyerjen e investimit fillestar, ortakët bien dakord që në rast se shoqëria do të realizoj një fitim vjetor, nga shpërndarja e dividendëve përkatës do të përfitojnë vetëm ortakët që zotërojnë respektivisht nga 30% të kuotave. Më pas dividendët do tu shpërndahen të gjithë ortakëve të shoqërisë, proporcionalisht me përqindjen e zotërimit të kuotave.

**Neni 17**  
**Likuidimi dhe prishja**


Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

**Neni 18**  
**Dispozita mbyllëse**

Ky Statut hartohet në gjashtë kopje ekzemplarë me fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

Z.Hamza Aburayyan



Tiranë, më 04/09/2022

